

P. nr.313/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit U. K. nga fshati L. K. Suharekë, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378/6-1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore- DP në Gjakovë, PP.nr.1748/15 të dt.02.06.2016, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë **03.01.2019**, në prani të Prokurorit të shtetit Ismet Tofaj si dhe te akuzuarit U. K., të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **U. K.** nga fsh. L., Komuna e Suharekës, data e lindjes ..., i biri i S. dhe i N. e gjinisë K., ka të kryer IV klasë të shkollës fillore, punëtor ndërtimi, i gjendjes se dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës Kosovës, i pamartuar, me ID

Ë s h t ë f a j t o r

Sepse :

- me date **14.07.2015** rreth orës **18:10 min.** në aksin rrugor **G. – R.**, saktësisht në hyrje të fshatit **R, K. Gjakovë**, rrezikon trafikun publik duke shkelur nenin 54 dhe nenin 225 lidhur me nenin 352 të Ligjit për Siguri në Komunikacionin Rrugor dhe vë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë në atë mënyrë që duke drejtuar automjetin e markës “...” me targa të regjistrimit ..., ngjyrë të verdhë, pa patent shofer, duke lëvizur pa pasur kujdes të shtuar në atë pjesë të rrugës si dhe duke mos ia përshtatur shpejtësinë e lëvizjes, kushteve dhe rrethanave në rrugë, ku si pasojë me pjesën e përparme të anës së majtë të veturës – kamionetës, e godet biciklistin, tani të dëmtuarin H. K. i cili në momentin kritik posa ishte kyçur në rrugë dhe kishte filluar kalimin e rrugës nga ana e majtë në të djathtë, me ç’ rast të dëmtuarit i shkakton lëndime të lehta trupore, të cilat lëndime më gjerësisht janë të konstatuara dhe të përshkruara hollësisht në ekspertizën mjeko-ligjore të datës 12.03.2016 nga eksperti mjeko-ligjor Dr. N. U.

-me çka ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378/6-1 të KPRK-së

Andaj Gjykata në bazë te nenit 4, 41, 49, 50, 51, 52, 73 ,neni 378/6-1 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPP, të akuzuarit i shqipton :

DENIM ME KUSHT

Dënim me burgim ne kohëzgjatje prej **4 (katër) muajve**, i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës se verifikimit ne afatin prej **1(një) viti**, nuk kryen ndonjë veper tjetër penale.

Për të dëmtuarin H. K. - përfaqësuesi ligjore babai J. K. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

I akuzuari obligohet që në emër shpenzimeve procedurale te paguaj shumen prej **71.10 euro** (në emër të ekspertizës së komunikacionit dhe ekspertizës mjeko-ligjore) si dhe ne emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **20,00 €**, në afat prej **15 ditëve**, pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë ,nën kërcënim të përbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP.nr.1748/15 të dt.02.06.2016, e ka akuzuar të akuzuarin U. K. nga fshati L. Komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378/6-1 të KPRK-së , duke propozuar që i akuzuari të shpallet fajtor të dënohet sipas ligjit dhe të obligohet në pagesën e shpenzimeve procedurale.

Gjykata konstaton se me dt. 06.01.2017, ka marr aktvendim mbi pezullimin e shqyrtimit gjyqësor ndaj të akuzuarit U. K. nga fshati L. Komuna e Suharekës, për shkak të pamundësisë së sigurimit të prezencës së tij meqenëse nga Stacioni Policor në Suharekë me njoftimin e datës 20.12.2016, ka njoftuar gjykatën se i njëjti është kërkuar por sipas informatave të mara në teren ky person jeton në Gjermani dhe ndaj tij ka lëshuar urdhër arrest P.nr. 313/2016 të datës 06.01.2017., të përsëritur me datë 14.12.2018.

Nga Stacioni Policor në Suharekë me datën 02.01.2019, i akuzuari U. K. është njoftuar lidhur me urdhërarrestin, është paraqitur në gjykatë me datën 03.01.2019, i njëjti është proceduar dhe ndaj të njëjtit është tërhequr urdhër arresti .

Gjatë shqyrtimit fillestar me dt.03.01.2019 përfaqësuesi i PTH-DP në Gjakovë, Prokurori Ismet Tofaj, lexoi aktakuzën PP.nr.1748/15 të dt.02.06.2016 dhe deklaroi se mbetet në tersi pranë aktakuzës.

I akuzuari U. K., gjatë shqyrtimit fillestar duke deklaruar lidhur me fajësinë thekson se e pranon në tërësi fajësinë sipas aktakuzës me të cilën pandehet duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimi të fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion , shtojë se me pranimin e fajësisë jam penduar për veprën e kryer nga pakujdesia, premtoi se një veprim i këtillë nuk do të përsëritet dhe në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm, kërkoi falje nga i dëmtuari gjegjësisht nga familja e të miturit për lëndimet e shkaktuara. Andaj i propozoi gjykatës që të merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimin e fajësisë ,premtimi se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të ngjashme, do të jem me i kujdesshëm si dhe faktin se është hera e pare që kam ra në ndesh me ligjin, po ashtu edhe faktin se nga familjarët e të dëmtuarit gjatë vizitës që kemi bërë kanë deklaruar se nuk i bashkëngjiten ndjekjes penale, të me shqiptojë një dënim më të butë.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari U. K. , me date 14.07.2015 rreth orës 18:10 min. në aksin rrugor G. – R., saktësisht në hyrje të fshatit R., K. Gjakovë, rrezikon trafikun publik duke shkelur nenin 54 dhe nenin 225 lidhur me nenin 352 të Ligjit për Siguri në Komunikacionin Rrugor dhe në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë në atë mënyrë që duke drejtuar automjetin e markës “...” me targa të regjistrimit, ngjyrë të verdhë, pa patent shofer, duke lëvizur pa pasur kujdes të shtuar në atë pjesë të rrugës si dhe duke mos ia përshtatur shpejtësinë e lëvizjes, kushteve dhe rrethanave në rrugë, ku si pasojë me pjesën e përparme të anës së majtë të veturës – kamionetës, e godet biciklistin, tani të dëmtuarin H. K. i cili në momentin kritik posa ishte kyçur në rrugë dhe kishte filluar kalimin e rrugës nga ana e majtë në të djathtë, me ç’ rast të dëmtuarit i shkakton lëndime të lehta trupore, të cilat lëndime më gjerësisht janë të konstatuara dhe të përshkruara hollësisht në ekspertizën mjeko-ligjore të datës 12.03.2016 nga eksperti mjeko-ligjor Dr. N. U.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë ,për shkak të se cilës gjykata nuk ka administruar provat ,gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPPK-ës. Gjate pranimi të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë ,pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat që i përmban aktakuza ,në materialet e prezantuar nga prokurori

i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qarte ligjore ose gabime faktike .

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit ,me pare duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike të tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit ,gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPK-së ,të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit . Rrethana rënduese nuk gjeti ,ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka marr parasysh personalitetit e të akuzuarit pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga i akuzuari, pendimin e tij, kërkim faljen nga i dëmtuari për lëndimet e shkaktuara, sjelljen korrekte të akuzuarit në gjykim, premtimin se një veprim i tillë nuk do të përsëritet dhe në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm, gjendjen e dobët ekonomike, si dhe faktin se është hera e parë që bie në ndesh me ligjin. Në këtë drejtim Gjykata ka marr parasysh edhe rrethanat e kryerjes së veprës penale përkatësisht shkaktimin e aksidentit i cili ka ardhur edhe me lëshimet e drejtuesit të biçikletës, i cili ka ndërmarrë veprimin e kalimit të rrugës nga e majta në të djathtë në drejtim të lëvizjes së automjetit pa verifikuar paraprakisht komunikacionin në atë pjesë të rrugës e kjo është shprehur qartë edhe në raportin ekspertizës së komunikacionit ,të cilat rrethana ndikuan që gjykata të zbatojë dispozitat e zbutjes se dënimit të parapara në nenin 73 të KPRK-ës. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin me kusht duke ia vërtetuar dënim me burgim në kohëzgjatja prej **4 (katër)** muajve ,i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (një) viti** , nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale ,do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marr bazuar në nenin 463/2 të KPP-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushalli gjyqësor bazohet në dispozitat e nenit 450 par.1 dhe 2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr.313/16 më datë 03.01.2019**

**Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë ,në afatin prej **15 ditësh** ,nga dita e marrjes se tij në dorëzim ,Gjykatës se Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.